

V E N D I M
Nr. 64, datë 23.1.2003

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE TË SEKSIONEVE TË
ADMINISTRIMIT DHE TË MBROJTJES SË TOKËS, NË KËSHILLAT E QARQEVE DHE
TË ZYRAVE TË MENAXHIMIT DHE TË MBROJTJES SË TOKËS, NË KOMUNA
DHE/OSE BASHKI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës, pranë këshillave të qarqeve, të kenë në përbërje të tyre numrin e punonjësve, të përcaktuar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pranë komunave dhe/ose bashkive, të kenë në përbërje një numër punonjësish, të përcaktuar me vendim të këshillit të komunës dhe/ose bashkisë, në varësi të sipërfaqes së tokës dhe të kushteve të territorit.

3. Në konkurrimin dhe emërimin e përgjegjësit dhe të punonjësve të seksioneve të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës pranohen dhe caktohen në detyrë vetëm specialistë me profesion agronom, gjeodet, gjeograf dhe ekonomist.

4. Plotësimi i numrit të punonjësve të seksioneve të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës të bëhet brenda organikës vjetore të numrit të punonjësve të këshillave të qarqeve.

5. Punonjësit e strukturave të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës të paguhën sipas vendimit nr. 726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.

6. Fondi i pagës së punonjësve të seksioneve të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës të përfshihet në buxhetin vjetor të këshillave të qarqeve, në fondin e kushtëzuar.

7. Fondi i pagës së punonjësve të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës, pranë komunave dhe/ose bashkive, të përfshihet brenda buzhetit vjetor të tyre, nga granti.

8. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1.1.2003.

9. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Numri i punonjësve të seksioneve administrimit dhe mbrojtjes së tokës

N/P	Emërtimi i Qarkut	Numri i punonjësve	Nëndarja administrative	Numri i punonjësve
1	BERAT	8	Berat Kuçovë Skrapar	4 2 2
2	FIER	12	Fier Lushnjë Mallakastër	5 4 3
3	GJIROKASTËR	8	Gjirokastrë Përmet Tepelenë	4 2 2

4	DIBËR	7	Peshkopi Bulqizë Mat	3 2 2
5	KUKËS	7	Kukës Has Tropojë	3 2 2
6	LEZHË	7	Lezhë Kurbini Mirditë	3 2 2
7	SHKODËR	8	Shkodër M.Madhe Pukë	4 2 2
8	VLORE	10	Vlorë Delvinë Sarandë	5 2 3
9	DURRËS	7	Durrës Krujë	4 3
10	TIRANË	7	Tiranë Kavajë	4 3
11	KORÇË	11	Korçë Devoll Kolonjë Pogradec	4 2 2 3
12	ELBASAN	10	Elbasan Peqin Gramsh Librazhd	4 2 2 2
	Totali	102		102